



UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY  
Rruga "Zija Shemsiu" p.n., 60000, Gjiilan, Republika e Kosovës  
[www.uni-gjilan.net](http://www.uni-gjilan.net) tel: 0280390112

---

Ref. nr. O 1 / 120 Dt. 21 / 01 / 2025

Në mbështetje të nenit 48 paragrafi 1, nën paragrafi 1.9 si dhe nenit 164 paragrafi 1 të Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka" Gjiilan, Senati i Universitetit, në mbledhjen e XXV të mbajtur më 20.01.2025, miraton:

**RREGULLOREN E PROCEDURAVE VLERËSUERE PËR ANGAZHIMIN E  
BASHKËPUNËTORËVE TË JASHTËM NË UNIVERSITETIN PUBLIK "KADRI ZEKA"  
GJILAN**

**Neni 1  
Qëllimi**

Kjo rregullore ka për qëllim të rregullojë procedurat vlerësuese për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm - me honorar për mbajtjen e ligjëratave, ushtrimeve, kolokfiumeve, provimeve, konsultimeve si dhe mentorimeve, sipas nevojës së njësisë akademike si dhe ndërlidhjen e programeve studimore të Universitetit Publik "Kadri Zeka" përmes procesit mësimor dhe praktik me tregun e punës, bazuar edhe në standardet e Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA).

**Neni 2  
Baza ligjore**

Kjo rregullore është hartuar duke u bazuar në dispozitat e Statutit të Universitetit Publik "Kadri Zeka", Ligjit mbi Arsimin e Lartë nr. 04/L-037 si dhe standardet e miratuara nga AKA.

**Neni 3  
Angazhimi bashkëpunëtorëve të jashtëm**

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm bazohet në nevojën e sigurimit të veprimtarisë së qëndrueshme të Universitetit Publik "Kadri Zeka" në përputhje me obligimet e tij, me theks të veçantë në aktivitetet si në vijim:

- 1.1. Aktivitetin mësimor (ligjërata dhe ushtrime);
- 1.2. Aktivitetin konsultativ;
- 1.3. Mbajtjen e kolokfiumeve dhe provimeve në lëndët në të cilat angazhohen;
- 1.4. Mentorimin e temave në nivelin bachelor;
- 1.5. Ndërlidhjen e procesit mësimor me tregun e punës përmes praktikës;
- 1.6. Procesin e sigurimit të cilësisë;
- 1.7. Përshtatjen me standardet e akreditimit.

2. Planifikimi i angazhimeve bazohet në nevojat reale për të siguruar veprimtarinë e qëndrueshme të Universitetit Publik “Kadri Zeka” përkatësisht njësisive akademike të tij.

#### **Neni 4 Periudha e angazhimit**

1. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm – me honorar bëhet për një semestër, përkatësisht për dy semestra, të të njëjtit vit akademik, ndërsa kontrata lidhet për vitin akademik përkatës.
2. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm – me honorar për semestër realizohet me kontrata në kohëzgjatje si në vijim:
  - 2.1. Kontratat për angazhim për *semestrin dimëror* lidhen prej datës 1 tetor deri më 15 shkurt për vitin përkatës akademik (për një semestër).
  - 2.2. Kontrata për angazhim për *semestrin veror* lidhet prej datës 15 shkurt deri më 30 qershor për vitin përkatës akademik (për një semestër).
3. Angazhimi i bashkëpunëtorëve të jashtëm – me honorar për një vit akademik realizohet me kontratë për periudhën prej 1 tetor deri më 30 qershor të vitit përkatës akademik.
4. Pas vlerësimit pozitiv të bashkëpunëtorit/es të angazhuar në cilësinë e profesorit, me propozim të dekanit angazhimi mund të vazhdohet edhe për 1 (një) vit akademik, por jo më shumë se 2 (dy) vite të angazhimit në tërësi (gjithsej 4 semestra), pa shpallur thirrje publike.
5. Pas vlerësimit pozitiv të bashkëpunëtorit/es të angazhuar në cilësinë e asistentit/es, me propozim të dekanit dhe vlerësimit nga profesori i lëndës përkatëse në të cilën asistenti/ja ka qenë i/e angazhuar, angazhimi mund të vazhdohet edhe për 1 (një) vit akademik, por jo më shumë se 2 (dy) vite të angazhimit në tërësi (gjithsej 4 semestra), pa shpallur thirrje publike.
6. Propozimi i arsyetuar i dekanit sipas pikës 4 dhe 5 të këtij neni, duhet të miratohet në këshill të njësisë akademike dhe pastaj të procedohet në senat për informim.
7. Thirrja publike për angazhim, pas aprovimit në këshill të njësisë akademike, miratohet në Senat.
8. I angazhuari ka për obligim që, në kuadër të kontratës, të mbajë provimet për të gjitha afatet brenda vitit përkatës akademik deri në mbarimin e semestrit të radhës në të cilën ligjërohet lënda përkatëse.
9. I angazhuari ka për obligim që në kuadër të kontratës t'i kryej të gjitha obligimet që dalin nga neni 3 kësaj rregulloreje.
10. I angazhuari mund të jetë anëtar i komisionit për mbrojtjen e temave në nivelin bachelor.
11. I angazhuari, nëse e ka titullin dr. sc. ka të drejtë të mentorojë kandidatët në nivelin bachelor.
12. Kompensimi i stafit të angazhuar bëhet duke u bazuar në orët e ligjëratave/ushtimeve dhe provimeve të mbajtura të dëshmuara me evidencën e nënshkrimeve të studenteve dhe të stafit akademik.

#### **Neni 5 Thirrja publike për angazhim të bashkëpunëtorëve të jashtëm**

1. Procedura e angazhimit bëhet nëpërmjet shpalljes së thirrjes publike për angazhimin e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
2. Përjashtim nga paragrafi 1 i këtij neni bëhet për kategoritë si në vijim:
  - 2.1. Nëse personeli akademik në marrëdhënie të rregullt pune, në bazë të normave ligjore në fuqi ka pezulluar marrëdhënien e rregullt të punës, nëse normat ligjore brenda dhe jashtë Universitetit Publik “Kadri Zeka” lejojnë mundësinë e angazhimit të tyre në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm.
  - 2.2. Nëse për shkaqe ose rrethana të arsyeshme të cilat mund të shfaqen pas fillimit të semestrit, ndonjë pozitë (lëndë) mbetet e lirë dhe ajo nuk mund të mbulohet me staf të rregullt dhe/ose stafin e angazhuar sipas thirrjes publike, atëherë me një arsyetim të bazuar të Dekanit, Rektori vendos që të bëjë angazhim të stafit të jashtëm, i cili i përmbushë kriteret e domosdoshme sipas kësaj rregulloreje.
  - 2.3. Personeli i cili në kohën e arritjes së moshës së pensionimit ka qenë në marrëdhënie të rregullt pune në Universitetin Publik “Kadri Zeka” dhe nëse njësisia akademike ka nevojë për angazhimin e tij. Angazhimi i kësaj kategorie të bashkëpunëtorëve mund të bëhet deri në moshën e lejuar me akte të veçanta dhe sipas procedurës së përcaktuar në nenin 4, paragrafin 7 të kësaj rregulloreje.

2.4. Profesorët vizitorë të punësuar në universitetet dhe institucionet e akredituara të arsimit të lartë jashtë vendit (për një numër të caktuar të ligjëratave deri në një semestër, ose 1 vit akademik për lëndet 2 semestrale), angazhohen me vendim të senatit. Kërkesa për angazhimin e profesorëve vizitorë duhet të bëhet nga dekani i njësisë akademike, bazuar në një raport të arsyetuar, duke u bazuar në nevojat e fakultetit/programeve, marrëveshjeve të bashkëpunimit me fakultete/universitete dhe institucione jashtë vendit. Kërkesa mund të bëhet edhe nga këshilli i fakultetit, përmes dekanit, bazuar në nevojën e departamentit/degës përkatëse. Kërkesa, së bashku me arsyetimin për pamundësinë e mbulimit dhe zhvillimit cilësor të orëve përkatëse nga ana e personelit në marrëdhënie të rregullt pune nga fusha e afërt dhe CV-në e profesorit vizitor potencial dorëzohen në rektorat. Në rast të miratimit të kërkesës në senat, profesorit vizitor i lejohej realizimi i orëve sipas sistemit bllok, për jo më shumë se gjashtë (6) orë brenda ditës së punës dhe jo më shumë se njëzet e katër (24) orë brenda muajit.

2.5. Profesorët vizitorë, në asnjë rrethanë, nuk mund të angazhohen për bashkëligjërime për më shumë se 4 orë ligjëratave në lëndët të cilat janë në kuadër të normës së personelit në marrëdhënie të rregullt pune.

2.6. Angazhimi i personaliteteve që kanë arritje të jashtëzakonshme ndërkombëtare në fushën e tyre. Për angazhimin e kësaj kategorie, dekani i njësisë akademike duhet të dergojë një propozim të arsyetuar në senat, që dëshmon arritjet e veçanta e të konfirmuara në nivel ndërkombëtar dhe CV-në e kandidatit/es, për angazhim deri në një semestër ose vit akademik.

3. Thirrja publike për angazhim shpallet nga senati me propozim të njësisë akademike, bazuar në nevojat e tyre për mbulesë të mbajtjes së ligjëratave, përkatësisht ushtrimeve me staf të angazhuar.

4. Një pozitë mund të shpallet edhe për orët e ligjëratave ose ushtrimeve që janë në kuadër të programeve të dy apo më shumë njësive akademike. Në këto raste, propozimi bëhet nga dekanët e njësive akademike përkatëse.

5. Thirrja publike shpallet në ueb faqen e Universitetit me kohëzgjatje prej tetë (8) ditëve kalendarike nga dita e shpalljes.

6. Kandidatët të cilët aplikojnë, duhet t'i dorëzojnë në kopje fizike të gjitha dokumentet e kërkuara në thirrje, përfshirë kopjen e diplomës së studimeve themelore, masterit dhe doktoratës, të noterizuar, të vërtetuar me vulë origjinale të noterit si dhe të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen edhe në formë elektronike.

7. Diplomati dhe gradat shkencore, të fituara jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHTI, para datës së mbylljes së thirrjes.

## **Neni 6**

### **Komisioni vlerësues**

1. Brenda 7 (shtatë) ditëve, pas hapjes së thirrjes, dekani i fakultetit thërret mbledhjen e Këshillit të Fakultetit, në të cilën merret vendim për formimin e komisioneve vlerësuese.

2. Komisioni vlerësues përbëhet nga 3 (tre) anëtarëve nga radha e profesorëve të rregullt me thirrje akademike nga universiteti. Në raste të veçanta, anëtarët e komisionit vlerësues mund të propozohen edhe nga njësitë e tjera të Universitetit Publik "Kadri Zeka" nëse përshtaten ose janë të përafërt me fushën përkatëse.

3. Komisioni vlerësues, pas përmbylljes së afatit të thirrjes ka për detyrë të thërras mbledhjen e komisionit dhe në koordinim me ta në afat jo më shumë se 10 (dhjetë) ditësh të hartojë raportin e vlerësimit, duke pasur parasysh këto obligime:

3.1 Të dorëzojë Raportin e komisionit vlerësues në fakultetin përkatës i cili publikohet në ueb faqen e UKZ-së jo më larg se 3 ditë nga dorëzimi;

3.2 Komisioni ka për obligim të shqyrtojë të gjitha aplikacionet e paraqitura për lëndët përkatëse. Komisioni harton raport për kandidatët që i plotësojnë kushtet formale - juridike sipas thirrjes;

3.3 Për kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet formale - juridike, komisioni duhet të shënojë në raport se cilat prej kushteve nuk i ka plotësuar secili prej kandidatëve;

3.4 Raporti i komisionit duhet të jetë i detajuar për kandidatët e përzgjedhur, ndërsa për secilin kandidat që nuk përzgjidhet duhet të theksohet një apo më shumë arsye të mos – përzgjedhjes;

3.5 Komisioni vlerësues i fton kandidatët që i plotësojnë kushtet formale - juridike në intervistë për vlerësim. Komisioni vlerësues bazohet edhe në performancën e treguar në Universitetin Publik “Kadri Zeka” (vlerësimi i ZZHAC për kandidatët e angazhuar në vitet paraprake);

3.6 Komisioni mban përgjegjësi ligjore, disiplinore dhe morale për vlerësimin e të dhënave në raportin e vlerësimit;

3.7. Komisioni mban procesverbal, lidhur me trajtimin e kërkesave për angazhim për të gjithë kandidatët e paraqitur në thirrje.

## **Neni 7** **Kushtet e angazhimit**

1. Personeli i angazhuar në cilësinë e bashkëpunëtorit të jashtëm nuk mund të marrë thirrje akademike.

2. Për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm, kandidatët duhet t'i plotësojnë këto kushte:

2.1. Për mësimdhënës:

2.1.1 Të kenë gradën shkencore Dr. nga lëmi përkatës (në lëndët e arteve figurative dhe të muzikës grada ekuivalente me të);

2.1.2 Të kenë përvojë pune si mësimdhënës;

2.1.3 Në mungesë të kandidatëve me gradën e doktorit të shkencave (Dr. Sc.) dhe nëse brenda njësisë akademike nuk mund të sigurohet kandidati me gradën e magjistratit (Mr. Sc.) ose Master (MA), i cili do të mund të angazhohej për mbajtjen e ligjëratave në lëndën e caktuar, në përputhje me Statutin, për pozitën e bashkëpunëtorit të jashtëm për ligjëratat në nivelin Bachelor mund të angazhohet kandidati me gradën Mr. Sc. ose MA, duke i dhënë përparësi kandidatit që ka të regjistruara studimet e doktoratës. Për të njëjtin, këshilli i njësisë akademike nxjerr vendim për t'ia besuar lëndën nën përkujdesjen e një profesori në marrëdhënie të rregullt pune në fushën përkatëse.

2.2. Për bashkëpunëtorë për mbajtjen e ushtrimeve:

2.2.1. Të kenë përfunduar studimet e rregullta Bachelor dhe Master apo ekuivalent në lëmin përkatës;

2.2.2 Të kenë notën mesatare jo më pak se 8 në të dy nivelet e studimit (veç e veç);

2.2.3 Studimet themelore dhe ato Master të kenë minimum 300 ECTS;

2.2.4 Kandidatët me gradën më të ultë se Master nuk mund të angazhohen për mbajtjen e ushtrimeve.

3. Në Universitetin Publik “Kadri Zeka” nuk mund të angazhohen kandidatët të cilët kanë më shumë se një angazhim në marrëdhënie të rregullt pune apo me honorar në institucionet tjera publike apo private me pagë primare apo sekondare.

4. Në rastin kur më shumë se një kandidat për pozitën përkatëse i plotëson kriteret e paragrafit 2.1 apo paragrafit 2.2, mbetet në diskrecion të komisionit vlerësues dhënia e përparësisë kandidatit të caktuar.

5. Nëse asnjëri nga kandidatët e paraqitur nuk i plotëson të gjitha kriteret e paragrafit 2.1 apo paragrafit 2.2 të këtij neni, është në diskrecion të komisionit vlerësues që të propozojë një kandidat, duke bërë arsyetim të veçantë për kandidatin/en që plotëson numrin më të madh të kriterëve të përcaktuara me këtë rregullore.

6. Në Universitetin Publik “Kadri Zeka” nuk do të lejohet angazhimi i kandidateve, brenda një njësie akademike, nëse brenda saj kanë në marrëdhënie të rregullt pune apo të angazhuar familjar të ngushtë (në relacion prind - fëmijë, vëlla - motër dhe anasjelltas, si dhe vëlla – vëlla apo motër - motër, bashkëshort - bashkëshorte dhe anasjelltas).

## Neni 8

### Afatet e vlerësimit, e drejta në ankesë dhe marrja e vendimit për angazhim

1. Kandidatët e pakënaqur me vlerësimin e komisionit vlerësues kanë të drejtë ankesë, në afatin prej 3 ditësh nga dita e publikimit të Raportit në web faqe të Universitetit Publik “Kadri Zeka”, drejtuar Këshillit të Fakultetit.
2. Komisioni i ankesave, i cili formohet nga Këshilli i Fakultetit dhe i cili përbëhet nga 3 anëtarë, pas përfundimit të afatit të ankesave do të përpilojë raportin dhe propozimet përkatëse dhe të njëjtin do t'ia dorëzojë Këshillit të Fakultetit. Raporti duhet të përgatitet brenda 3 ditëve.
3. Këshilli i Fakultetit, jo më shumë se 3 ditë nga dita e pranimit të Raportit të Komisionit të Ankesave duhet të shqyrtojë Raportin e Komisionit të Ankesave dhe të vendosë për miratimin apo refuzimin e tij.
4. Nëse pala nuk e ankimon vendimin e Këshillit të njësisë akademike brenda afatit ligjor, vendimi i Këshillit të njësisë akademike bëhet përfundimtar.
5. Pala ka të drejtë të paraqesë ankesë ndaj vendimit të Këshillit të Fakultetit në shkallën e dytë, para Komisionit për Ankesa dhe Parashtrës të Senatit, brenda 5 (pesë) ditësh nga data e marrjes së vendimit të këshillit të njësisë akademike.
6. Komisioni për Ankesa dhe Parashtrës i Senatit miraton ose refuzon pretendimet e kandidatëve, çështja konsiderohet e mbyllur me vendim përfundimtar Senatit.
7. Vendimi përfundimtar i Senatit ose vendimi përfundimtar i Këshillit të Fakultetit (në rastet kur nuk ka ankesa) së bashku me listën e kandidatëve të pranuar si bashkëpunëtorë të jashtëm, dërgohet në Senat për informim.

## Neni 9

### Nënshkrimi i kontratës për angazhim

Pas informimit të senatit me listën e bashkëpunëtorëve të jashtëm, rektori nënshkruan kontratat e të angazhuarve.

## Neni 10

### Të drejtat dhe obligimet

1. Angazhimi sipas kësaj rregulloreje nuk nënkupton themelim të marrëdhënies së rregullt të punës.
2. Kandidatëve të angazhuar, në cilësinë e bashkëpunëtorëve të jashtëm, nuk iu takon e drejta në pushim vjetor dhe as kompensim të përvojës së punës.
3. Kandidatët e angazhuar bartin përgjegjësi ligjore për mënyrën e shfrytëzimit të aseteve të Universitetit Publik “Kadri Zeka”.

## Neni 11

### Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbi procedurat e angazhimit të bashkëpunëtorëve të jashtëm – me honorar të Universitetit Publik “Kadri Zeka” Gjilan, Rregullorja me Ref. Nr. 01/1473 e datës: 09.07.2021.

## Neni 12

### Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Senati i Universitetit Publik “Kadri Zeka” në Gjilan.



Kryesues i Senatit  
Prof. Asoc. Dr. Artan Dërmaku, Rektor

*Artan Dërmaku*